



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.635/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Viva Fresh” SH.P.K, me NUI 810670390 me seli në Suhodoll, Graçanicë, me përfaqësues të autorizuar A.B., kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit nr. 5752 dt.10.08.2021 dhe Vendimit 6565 dt.10.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 26.08.2024, me pjesëmarrje të përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, më datë 30.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Viva Fresh” SH.P.K, me NUI 810670390 me seli në Suhodoll, Graçanicë, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi nr. 5752 dt.10.08.2021 dhe Vendimit 6565 dt.10.09.2021 i të paditurës, **si e pa bazuar.**

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 22.09.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “Viva Fresh” SH.P.K, me NUI 810670390 me seli në Suhodoll, Graçanicë, përfaqësuar nga pronari Xh.R., ka parashtruar kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulim të vendimit nr. 5752 dt.10.08.2021 dhe Vendimit 6565 dt.10.09.2021. Lënda është evidentuar me nr. A.2182/2021.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 635/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor në seancë publike më datë 26.08.2024 me pjesëmarrje të përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur nga Avokatura Shtetërore Besim Zllashi me autorizim, konform nenit 41 të LKA-së, i ftuar në mënyrë të rregullt i cili ftesën për në seancë e pranuar më datë 02.08.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar anulimin e vendimit Nr.5752 të datës 10.08.2021 dhe vendimi Nr.6565 i datës 10.09.2021. Deklaron se paditësja “Viva Fresh” e ka argumentuar me prova të mjaftueshme se padia dhe kërkesa padia është e bazuar në prova të cilat janë bashkangjitur në padi. Vendimi i kundërshtuar është marr në kundërshtim me ligjin dhe gjendjen faktike. Duke u bazuar në faturën e blerjes së konsumatorit e cila lëshohet vetëm për nevojat e brendshme të kompanisë, dhe e cila është me detajuar se kuponi fiskal që i lëshohet konsumatorit me rasti e blerjes shihet qartë se tek emërtimi i produktit të blerë konsumatori e ka blerë pakon me Nescafe e cila në brendi ka 28 copa, andaj çmimi i paguar të arka fiskale ka qenë 3.36 euro njëjtë si në rastin siç ka qenë i ekspozuar produkti, me ç’rast nënkuptohet se në këtë rast nuk ka pasur asnjë mos përputhje të çmimeve apo ndonjë shkelje të dispozitave ligjore por problemi ka qenë tek pakujdesia e konsumatorit i cili gjatë

blerjes nuk ka shikuar çmimet e ekspozuara të produkteve dhe ka ngatërruar çmimin e nescafes me 24 copa me atë prej 28 copa. Ndërsa, Viva Fresh i ka pasur të vendosura çmimet për secilin produkt në vendin e vet dhe çdo konsumator paraprakisht ka qenë i njoftuar me çmimoren e çdo produkti të renditur në raft. Si pasojë e këtyre rrethanave ka ardhur deri te kjo situatë ku i njëjti është ndëshkuar pa bazë ligjore dhe në mungesë të provave dhe fakteve. Gjykatës i propozon që të aprovohet ne tërësi padia dhe kërkesë padia e paditëses, të anulohet vendimi numër 5752 i datës 10.08.2021 dhe vendimi nr. 6565 i datës 10.09.2021 të cilat janë marr në kundërshtim me ligjin dhe të obligohet e paditura që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Kundërshtimet e të paditurës

5. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtrësës së datës 11.03.2024 ka deklaruar se kërkesëpadia është e pabazuar, me arsyetim se në produktin e ofruar për konsumatorë “Nescafe” 3x1 24x16.5, çmimi në fletushkë ishte 2.88 €/cent, ndërsa çmimi i pagesës përfundimtare në arkën fiskale kishte kaluar 3.36 €/cent. Në kundërshtim me nenin 26.7 dhe 8 të Ligjit 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit (LMK), prandaj Inspektorati i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 1000.00 (njëmijë) euro, gjobë e përcaktuar me nenin 137. paragrafi 1.1 dhe 1.11 të LMK. LMK përcakton që shitësi ka për obligim të vendos qartë, dukshëm dhe lexueshëm çmimin e shtijës së mallrave dhe të garantoj se çmimi i paguar do të jetë i njëjtë me çmimin e ekspozuar.
6. E kundërshton si të pabazuar pretendimin e paditësit duke ju referuar kartelës së shitjes se konsumatori nuk ka shikuar çmimet e ekspozuara të produkteve dhe ka ngatërruar çmimin e nescafes me 24 copa me atë prej 28 copa. Sepse deklaroi se paditësi Viva Fresh në momentin e inspektimit nuk ka pasur produkt tjetër në zbritje siç pretendohet. Prandaj deklaroi se paditura ne vendimin me numër 5752 i datës 10.08.2021 dhe vendimi nr. 6565 i datës 10.09.2021 i ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat dhe provat të cilat kanë ndikuar në

nxjerrjen e vendimit ligjor dhe të drejtë. I propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i kundërshtuar.

Provat e administruara

7. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Procesverbal Inspektimi tek paditësi “Viva Fresh” me numër 19/00121, Aktvendimi 5752 me datë 10.08.2021 nga MINT, Ankesë e paditësit Viva Fresh me nr.prot.5957 me datë 19.08.2021, Çmimi i ekspozuar i produktit *Nescafe*, Kupon fiskal me nr. 0085 me datë 07.08.2021, Faturë e datës 07.08.2021, Vendim me numër 5752 i datës 10.08.2021, Vendimin me numër 6565 me datë 10.09.2021.

Vlerësimi i gjykatës

8. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
9. Nga provat e administruara gjykata vlerësoj sipas Raportit të inspektimit tek paditësi “Viva Fresh” me numër 19/00121 më datë 07.01.2020, të realizuar sipas ankesës së konsumatorit, është konstatuar se çmimet janë të vendosura në rafte, mirëpo nuk janë të harmonizuara në arkë. Çmimi i produktit “Nescafe” 3x1 24x16.5, ishte reklamuar në fletushkë të subjektit afarist, nga data 06-12 gusht 2021, me çmim 2.88 €/cent, ndërsa çmimi i pagesës përfundimtare në arkën fiskale me datë 07.08 kishte kaluar 3.36 €/cent.
10. Çmimi i produktit *Nescafe 3in1 16.5 gr.* në Kupon fiskal me nr. 0085 me datë 07.08.2021 është 3.36 €, ndërsa në Faturë të datës 07.08.2021 evidentohet “*Nescafe 3in1 16.5 gr*” “Nescafe” 3x1 28x17.5, 3.36 €.

11. Gjykata shqyrtoj pretendimi e përfaqësuesit të paditësit se *fatura e blerjes së konsumatorit e cila lëshohet vetëm për nevojat e brendshme të kompanisë, dhe e cila është me detajuar se kuponi fiskal që i lëshohet konsumatorit me rasti e blerjes shihet qartë se tek emërtimi i produktit të blerë konsumatori e ka blerë pakon me Nescafe e cila në brendi ka 28 copa, andaj çmimi i paguar të arka fiskale ka qenë 3.36 euro njëjtë si në rastin siç ka qenë i ekspozuar produkti, me ç'rast nënkuptohet se në këtë rast nuk ka pasur asnjë mos përputhje të çmimeve por problemi ka qenë tek pakujdesia e konsumatorit të cilin e vlerëson të pabazuar, sepse konstaton se të gjitha produktet në faturë të blerjes së konsumatorit dhe në kupton fiskal të konsumatorit përputhen me të gjitha specifikat dhe janë mjaft të detajuara për secilin produkt, me përjashtim të produktit në fjale i cili në kupon fiskal evidentohet “Nescafe” 3in1 16.5 gr”, ndërsa në Faturë të blerjes evidentohet dy here dhe atë: “Nescafe” 3in1 16.5 gr”, “Nescafe” 3x1 28x17.5, 3.36 €.*
12. Prandaj, për këtë arsye si dhe duke pasur parasysh faktin se paditësja “Viva fresh” në momentin e Inspektimit nga Inspektorati i Tregut nuk ka dëshmuar se kishte produkt tjetër të Nescafes në zbritje, (e cila ishte e përfshirë në fletushkë të zbritjeve), dhe nuk ka dhënë asnjë vërejtje me rastin e konstatimit të gjendjes faktike në procesverbal të inspektimit të datës 09.08.2021, gjykata vlerëson se provat e propozuara dhe të paraqitura me ankesë të datës 19.08.2021 nuk janë të besueshme, sepse të njëjtat përderisa nuk janë përfshirë në kupon fiskal dhe nuk janë prezantuar me rastin e inspektimit, ekziston dyshimi se janë të manipuluar nga paditësja, për faktin se nuk ka asnjë arsye për të besuar se fatura vetëm për një produkt nuk reflektojka specifikat e detajuara të produktit - përderisa të gjitha produktet tjera janë në mënyrë të njëjtë të detajuara si në kupon fiskal dhe në faturë.
13. Prandaj gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk u vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar me Vendimin me numër 5752 i datës 10.08.2021, Vendimin me numër 6565 me datë 10.09.2021, i cili është marrë në përputhje me LMK, Neni 26 ku përcaktohet *1. Tregtari duhet të shënoj çmimin e shitjes dhe çmimin e njësisë për të gjitha produktet e ofruara. Çmimi për njësi nuk ka nevojë të tregohet nëse është identik me çmimin e shitjes. paragrafi 8. Shitësi duhet t'i garantoj konsumatorit se çmimi i paguar do të jetë i njëjtë me çmimin e ekspozuar sipas paragrafit 7 të këtij neni dhe Neni 137 1.*

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë: 1.1. Personi juridik – tregtari do të dënohet në një shumë prej njëmijë (1.000) euro deri dhjetëmijë (10.000) euro për një shkelje, nëse: 1.11. dështon për të krijuar një çmim të shitjes dhe/apo për njësi të qartë, te dukshëm dhe të lexueshëm për pakicë dhe/apo shumicë të mallrave ose shërbimeve të ofruara sipas neni 26 paragrafi 7 dhe gjithashtu në qoftë se ai dështon për të garantuar konsumatorin se çmimi i paguar do të jetë i barabartë me çmimin ofruar sipas Nenit 26 paragrafi 9 të këtij ligji.

14. Andaj bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së, ne procedurë administrative secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.635/22, datë 30.08.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.